



**Sit ë arrihet deri te një sistem arsimit sipëror kualitativ në
Maqedoni**

Shqyrtim i reformave në procesin e arsimit sipëror në Maqedoni

Përmbledhje

Duke e konsideruar sistemin e arsimit të një rëndësie të posaçme drejt integritit të Maqedonisë në UE, Analitika inicoi këtë hulumtim me qëllim që të gjenerojë informata dhe analiza rreth efektivitetit të politikave qeveritare në zhvillimin e sistemit të arsimit sipëror, monitorimin e formulimit dhe implementimit të këtyre politikave si dhe identifikimin e zbrazëtirave ndërmjet politikave (qeveritare dhe institucionale) dhe implementimit të tyre në praktikë. Prandaj, theksi kryesor në këtë analizë bie mbi atë se:

- Si është vendosur strategjia për zhvillim kombëtar të sistemit të arsimit sipëror në raport me kapacitetin potencial të këtij sektori?
- Si dhe me çfarë masash është ndryshuar korniza politike nacionale rreth sistemit të arsimit sipëror në raport me regullativën e UE-së?
- Cili është impakti i implementimit të kësaj politike në segmentë të ndryshëm, përfshirë qeverisjen, finansimin, praktikat administrative, reformat e programit mësimor etj?

Gjatë procesit të hulumtimit, një numër i caktuar subjektsh të involvuar në sistemin e arsimit sipëror kanë qenë të intervistuar, përfshirë ata në pozitat meaxheriale, akademike si dhe studentë. Të dhënat statistikore, të përdorura në këtë raport janë të diskutuara me ekspertë vendorë me qëllim që informatat kuantitative të ndërlidhen me perspektivat e ndryshme të eksperiencës personale të subjektëve në fjalë. Duke u thelluar në materjen e kësaj teme, tendenca e qasjes së tillë multidisiplinare është e parapare të konsistojë në fleksibilitet më të madh në kontekstin specifik socio-politik, me qëllim që të ofrojë balancin poshte-lartë si dhe një vështrim autoritativ, i cili do të demonstrojë një të vërtetë të arritshme rreth rekomandimeve për hartuesit e politikave.

Përmbajtja e raportit në fjalë është strukturuar në katër kapituj, secili duke trajtuar aspekte të ndryshëm të sistemit të arsimit sipëror në Maqedoni. Në fund të secilit kapitull janë prezentuar rekomandime për të ndikuar në përmirësimin e performancave në përgjithësi të këtij sistemi.

Informata të përgjithshme: Duke u mbështetur në përmbledhjen historike dhe në analizat statistikore relevante, ky kapitull tregon se në këtë aspekt, aktorët relevantë duhet të krijojnë strategji afatgjate për rritjen e numrit të të regjistruarve nëpër fakultete, i cili do të mbështeteshte në kapacitetet egzistuese dhe trendet zhvillimore. Esenciale është që të përfshihen të dy sektorët, publik dhe privat, me qëllim që të arrihen rezultate më të volitshme në aspekt të studentëve të diplomuar dhe ofrimi i mundësive për profesionalizim të tyre të mëtutjeshëm.

Finansimi: Indikatorët financiar në sistemin e arsimit sipëror argumentojnë rëndësinë esenciale për të vendosur lidhje direkte ndërmjet performancave dhe finansimit, siç janë raportet vjetore dhe kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm bazuar në indikatorë të qartë të performancës që do të prodhojnë qasje në informata për publikun. Praktika aktuale tregon raporte financiare të pabesueshme, me mungesë të parametrave kualitativ dhe konsekuencave të dukshme mbi finansimin e mëtutjeshëm. Indikatorët duhet të ofrojnë mekanizma të përgjegjshëm për sigurimin e kualitetit dhe të inkurajojnë zhvillim të

përmbajtshëm të strategjive afatgjate për institucionet që do të sugjerojnë përdorim racional të fondeve publike. Për më tepër, institucionet relevante duhet të marrin parasysh masa për përforcimin e interesit në klasifikimin e fondeve të sistemit publik të arsimit sipëror.

Struktura organizative: Ligji aktual mbi arsimin sipëror i vitit 2008, parasheh mundësi në drejtim të profesionalizimit të strukturave menaxheriale me vendosje të antarëve të jashtëm në pozita menaxheriale, gjë që paraqet dyshim tek bashkësitë akademike rreth asaj se si distribuohet fuqia administrative. Kjo sjell deri te rreziku për mospranimin e vendimeve të sjella pa mbështetjen e aktorëve autoritativë të bashkësisë akademike si dhe ndërhyrja e fuqisë politike në autonominë e institucioneve.

Në këtë sektor nevojitet thjeshtësim i strukturës së përgjithshme organizative me shpërndarje të qartë të përgjegjësi ndërmjet subjekteve administrative. Në të njëjtën kohë, është e domosdoshme të themelohen subjektë të veçantë administrativ të cilët do të kontrollojnë shpërndarjen dhe shpenzimin e finansave publike dhe në këtë mënyrë do të pengoheshte varësia politike në menaxhimin e institucioneve të arsimit të lartë.

Programet mësimore dhe sigurimi i kualitetit në arsimin sipëror: Për përmirësimin e gjendjes rreth kualitetit në institucionet e arsimit të lartë nevojitet ndërmarrje e masave urgjente. Roli i ligjërueseve duhet të rishikohet me qëllim që të stimulohet interaksioni ndërmjet profesorëve dhe studentëve. Detyrat për studentët duhet patjetër të jenë të definuara përmes programeve studimore ashtuqë do të ndryshoheshte praktika e deritanishme marrja e notave për marrje të diturisë.

Informatat për mënyrën e përmirësimit të procesit arsimor duhet patjetër të jenë të shpërndara ndërmjet bashkësisë akademike nga ana e institucioneve qeveritare dhe të arsimit sipëror me organizim të punëtorive dhe projekteve. Parametrat për vlerësim të kualitetit duhet patjetër të jenë të vendosur në nivel kombëtar duke përfshirë elementet si: mundësitë infrastrukturore, kualiteti për kuadrin e arsimit sipëror, lehtësirat arsimore, qasja në informacione etj.

Mungesat në sektorin e arsimit sipëror të detektuar në këtë raport, do të jenë lëndë e analizave të mëtutjeshme në raportet e ardhshme të institutit Analitika. Marrë parasysh rregullativat evropiane, Analitika do të vazhdojë në raportet e ardhshme të adresojë çështjet e finansimit, organizimit dhe kualitetit të sektorit të arsimit sipëror, në tre fusha kryesore: Implementimi i ECTS; Implementimi i kornizës ligjore në raport me strukturën organizative; Inicimin e principeve për integrim social në sistemin e arsimit sipëror.

Arsim dhe kulturë

Publikime të ardhshme:

“Implementimi i ECTS në Maqedoni”

Kontakt

Analitika

Dame Gruev 7-8/3
1000 Shkup, Maqedoni
tel: + 389 2 312 1948
web: www.analyticamk.org
info@analyticamk.org

Hulumtues për programin e arsimit dhe kulturës

Katarina Kreçeva
krecheva@analyticamk.org

Analitika - organizate e pavarur joprofitabile e perkushtuar per te ndihmuar persona dhe institucione ne perforcimin dhe permiresimin afatgjate te demokracise dhe udheheqjes si ne R. e Maqedonise ashtu edhe me gjere ne rajon.

Analitika eshte organizate per analize dha hulumtim te politikave publike (think-tank), e perkushtuar ne promovimin dhe zhvillimin e bashkpunimit ndermjet subjekteve dhe organizatave ne R. e Maqedonise dhe me gjere.